

Në një manifestim të mbajtur në Gjermani

Diaspora dëshmoi se "është e gatshme për pavarësi"

Para pak ditësh me organizimin e departamentit të kulturës të lobit shqiptar në Evropë dhe në bashkëpunim me Unionin Artistik të Kombit Shqiptar, në Hassloch afër Ludwigshafenit u organizua një manifestim në prag të pavarësisë së Kosovës me moton: Jemi gati për pavarësi! Me këtë manifestim diaspora shqiptare dëshmoi se po përgatitet për ditën e madhe mbarëshqiptare të pavarësisë së Kosovës që pritet të shpallet së shpejti në Prishtinë.

Me një pjesëmarrje të madhe të bashkatdhetarëve tanë nga të gjitha trojet shqiptare

manifestimi me moton "Jemi gati për pavarësi" u hap në mënyrë solemne me ç' rast katër grupe valle hynë në sallë nga të katër anët e saj, lëvizje kjo që i ngjante një dasme të madhe. Kjo ngriti në këmbë gjithë publikun i cili u bë bashkë duke kënduar këngën "Jemi gati për pavarësi", nën shoqërimin e katër grupeve të orkestrave. Ky prezantim u realizua nga grupi i valleve shqiptare i shoqërisë kulturore "Kosova" nga Singeni, e kryesuar nga koreografi i mirënjohur Rrustem Selca dhe nga grupi i shoqatës për kulturë, rinë dhe sporte me kryetar Qerim Shkrellin dhe koreograf Nazim Bajrami. Po ashtu edhe pjesëmarrja e të gjithë këngëtarëve dhe këngëtarëve si dhe e muzikantëve tjerë bëri që realizimi i këtij programi kulturor të ishte ndryshe nga herët e tjera.

Programi u hap me këngën "Marshi i UÇK-së, kënduar nga Qamil Zeka dhe pastaj u vazhdua me këngën "Në Prekaz pushka ka krisi" nga këngëtarit tjetër Halil Kryeziu. Atmosferë e jashtëzakonshme u krijua në sallë kur këngëtarja e mirënjohur e diasporës Mera Zymeri këndoi këngën e komandantit legjendar Adem Jashari. Me këtë rast duhet cekur se Mera, së bashku me bashkëshortin, Afrimin dhe të atin, Daut Zymerin, kishin bërë 500 km për të qenë pjesëmarrës në këtë gëzim të bashkatdhetarëve, e gjithë kjo në baza humanitare. Për kontributin e dhënë për ruajtjen e këngës tradicionale shqiptare edhe në mërgim, zonja Zymeri u nderua me titullin "Nderi i kombit" nga Unioni Artistik i Kombit Shqiptar, të cilin ia dorëzoi kryetari i Lobit shqiptar në Evropë z. Nikollë Shabani. Ai me këtë rast veç tjerash tha: "sonte është natë e veçantë për të gjithë shqiptarët kudo që janë sepse po presim një dasmë të përbashkët mbarë shqiptare që e kemi pritur për shumë vite. Ai premtoi se lobi shqiptar do të organizojë pjesëmarrjen e shqiptarëve në atë që ai e quajti "Dasmë e madhe" në Prishtinë sepse e gjithë diaspora ka kon-



SHKA "Kosova" e Singenit, pjesëmarrëse e aktivitetit



Këngëtarja Mera Zymeri

tribuar për arritjen e kësaj dite. Prishtina do të jetë sofer e shtruar për të gjithë shqiptarët atë ditë dhe për të gjithë migët e shqiptarëve kudo që janë në botë dhe e duan Kosovën e pavarur. Mirë u takofshim në Prishtinë", përfundoi fjalën e tij z. Shabani. Ndërkaq Sheremet Pantina, Qerim Shkrelli, Hasan Hajdari, Begzat Gashi, Rasim Sadiku, Ejupi etj. lu drejtuan pjesëmarrësve në emër të atyre që përfaqësonin dhe i ftuan ata që të marrin pjesë në festimet e shpalljes së pavarësisë së Kosovës dhe me këtë rast të jenë të bashkuar për të dëshmuar se kontributi i diasporës për këtë ditë ka qenë veçanërisht i madh. Vlen për tu theksuar me këtë rast kontributi i veçantë në realizimin e këtij manifestimi kombëtar dhe kulturore i këngëtarëve si: Arta Osmani, Lulzim Toverlani, Halil Kryeziu, Qamil Zeka, dueti vëlla e motër Mriaj pastaj Naser Gashi, Islam Mustafa, Asilan Sylja, Mustafa Gashi, si dhe instrumentistët Pajazit Zhegrova,

Afrim Zymeri, Trabuin Meha, vëllezërit Gashi etj. Të gjithë këta k premtuan se së bashku me organizatorët, në të ardhmen në këtë sallë do të ketë për çdo fundjavë muzikë origjinale shqiptare, ku bashkatdhetarët tanë e në mënyrë të veçantë rinia shqiptare të kenë një ambient për tu argëtuar me muzikën tradicionale shqiptare. Gatishtëria e Skënder Krasniqit, Rushan Tocit, Femi Krasniqit si dhe shefit të lokalit, Janit, bëri të mundur vënien në dispozicion të kësaj salle të bukur për realizimin e këtij aktiviteti madhështor. Rreshtat e gjatë të grupeve të valleve si ai i Singenit, Sinshaimit, e Pforzhaimit jepnin për të kuptuar se vërtetë jemi në dasmë gëzimi. Valltari i vogël

dy vjeçar Flamur Bajrami në mesin e këtyre valltarëve veshur me rrobat kombëtare me shqiponjën në gjoks e ndjente shumë gëzimin dhe imitonte të rriturit.

Ky manifestim vazhdoi deri në orët e vona të natës dhe nuk munguan shprehjet e gatishtërisë së diasporës për të marrë pjesë në ditën e pavarësisë së Kosovës. Me këtë rast kryetarja e gruas shqiptare Afërdita Shkrelli premtoi se do të sigurojë rrobat kombëtare për grupet që do të marrin pjesë në karvanin e dasmës në Prishtinë kurse nxënësja Blerita Pantina me poezinë për Adem Jasharin përshëndeti të gjitha familjet e dëshmorëve dhe invalidëve të luftës.

Në mbyllje të gjithë paraqitën gatishmërinë për të shkuar në mënyrë të organizuar në ditën e pavarësisë së Kosovës. Manifestimi u mbyll me të njëjtën këngë që u këndua në fillim: "Jemi gati për pavarësi".

(Can Gashi)



FTESË

Bashkatdhetarët

Me rastin e 11 vjetorit të rënies së dëshmorëve të kombit Zahir Pajazit, Hakif Zejnullehu, Edmond Hoxha, artistit Elbasanas Isail Hodo jep koncertin e tij recital me temë: "ZEMRA NËPËR LAPIDAR MË ËSHTË NDAR". Në këtë mbrëmje marrin pjesë z. Ilir Hallilaj konsull pran ambasadës Shqiptare në Berlin, Regjisorit i teatrit kombëtar z. Spiro Duni, moderon: Vjollca Hajdari zëdhënëse e RTK-së, përcjell këtë recital RTK.

32 fëmijë, d

Një ndihmë financiare madhe

Në prill të vitit 2008, në 5 qytete të muzikës të Gjilanit së bashku me 1 të Cyrihut do të ekzekutojnë bashkë dhe zviceranë. Këto koncerte realizohen së Zvicrës, Ruth Dreifuss. Aktiviteti një film dokumentar me titull "korica kompani filmike zvicerane. Një pjesë të shpenzimeve për ardhjen ta bartë vetë diaspora shqiptare. Për realizon një hap të madh kulturor.

Informatat rreth koncerteve dhe merren në www.balkanspring.com (Xhevdet Kallaba) ose +41(0)7... +41(0)7...

Në Londër, më 10 shkurt
nga Vetëvendosjen

Dokumentar demonstratës

Njoftojmë bashkatdhetarët se në 10 shkurt të 2007 demonstratës së 10 Shkurtit 2007 aktivistëve të saj, Lëvizja Vetëvendosjen dokumentar "10 Shkurti" nëpër të Ky film do të shfaqet në Swiss Cot Road, London NW3 3NR, të dielën. Hyrja është falas, mirëpo do të organizohet për realizimin e projektit qendror-memorëve dhe ngritja e memorialit për Mirëpresim ardhjen tuaj! Erzen Vraniqi, Qendra e lëvizjes V

Suksese të artistëve tanë në botë

Pikturat e Naimit në Covent Garden të Londrës

Më 09-10 shkurt
Turne në Fu

FC. Prishtina organizon Turneun tradicio